

**NE EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA THEMELORE NE GJILAN-DEPARTAMENTI I PËRGJITHËSHEM-përmes gjyqtarit të vetëm gjykues me sekretaren juridike Naile Neziri, në lëndën penale ndaj të pandehurit M. L.nga fshati P., k. Gj., për shkak të veprës penale vjedhje pylli nga neni 358 paragrafi 1 të KPRK-se., sipas aktakuzes se Prokurorisë Themelore ne Gjilan PP.II.nr.104/16 te dates 14.01.2016, te cilin e përfaqësonte prokurori i shtetit Shefik Memeti , pas mabjtjes së seancës kryesore me daten 18.10.2016, po ate ditë ne prani të palëve publikoi këtë :

**AKTGJYKIM**

I akuzuari M. L., nga i ati I. dhe nëna S. e lindur R., i lindur me datën ... ne fshatin P., K. Gj. ku edhe tani jeton, i martuar babe i ... fëmije të ..., ... ,ka të kryer shkollën e ..., me gjendje të varfër ekonomike, shqiptar. Shtetas i Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

**SEPSE**

Me datën ... .2016, rreth orës ... minuta ne territorin e fshatit D. komuna e gj., i pandehuri M. L.me qëllim të përfitimi të kundërligjshëm pasuror për vehte, në pronën private të të dëmtuarit N. M., në vendin e quajtur “ ...”, ka vjedhur dru , në atë mënyre që me sharrë motorike ka prerë 5 copa drunjë të llojit ahui, me diametër në cung 32-35 cm, në lartësi të drurit 15 cm , me vëllim të përgjithëshëm 3.80m<sup>3</sup>, në këtë mënyre i pandehuri me veprimet e vet ate dëmtuarit të sipershenuar, i ka shkaktuar dëm matrial në shumën prej 513.00 €

Me çka ka kryer veprën penale vjedhje pylli, nga neni 358 paragrafi 1 te KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitave të lartcekura penale pastaj të nenëve 4, 7,17,21,45,73,76 të KPRK-se si dhe nenëve 365, 451, 463 te KPRK-së, atij i shqipton;

**DËNIM ME GJOBË**

Te akuzuarit M. L. denimi në fjal në vlere prej 300.00 (treqind) €, të cilin dënim i akuzuari duhet që ta paguaj në afatin prej 15 ditëve, nga dita e plotefuqishmëris së këtij aktgjykimi , e në te kundërt atij do i zëvendësohet me dënim me burg ku me nga 20 € do te zëvendësohet për nga 1 ditë burgimi.

Pala e dëmtuar N. M. nga K., për realizimin e kërkeses pasurore juridike, udhëzohet ne contest civil.

Obligohet i akuzuari që në emer të paushallit gjyqesor të paguaj 20 € si dhe në emer te hargjimëve të procedurës penale, shuma e përgjithëshëm sipas llogarisë përfundmitare të kësaj gjykate, te gjitha këto në afatin prej 15 diteve nga dita e plotefuqishmëris së këtij aktgjykimi, nën kercënimin e dhunës.

**ARSYETIM**

Prokuroria Themelore në Gjilan, me aktakuzen e saj me shkrim PP.II.nr 104/16 të datës 14.01.2016, të paraqitura në këtë gjykatë ka akuzuar të akuzuarin M. L. nga fshati P., për shkak të kryerjes së veprës penale vjedhje e pyellit nga neni 358 paragrafi 1 të KPRK-së.

Në shqyrtimin gjyqësor kryesor të datës 18.10.2016 prokurori i shtetit Shefik Memeti në fjalën e tij përfundimtare pos tjerash pohoi se gjatë shqyrtimit të sotëm gjyqësor prokurori i shtetit të gjitha provave, si dhe vërtetoti se i akuzuari M. L. është fajtor për shkak të veprës penale të lartëcekur andaj deklaroj që i njejti të shpallet fajtor dhe ti shqiptohet dënim meritor i bazur në ligj.

I akuzuari M. L. në fjalën e tij përfundimtare, pos tjerash pohoi se nuk e ndien vetën fajtor, pasi që deklaroi se drute i kishte prerë në malin e vet dhe se nuk e kishte prerë pyllin e te dëmtuarit, por pasi që nuk kishte dokumentacionin valid për transporte e të njejtëve dhe ato drut nuk ishin të damkosura, andaj kërkoj që të lirohem nga përgjegjësia penale.

Pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor gjyqësor dhe public të datës 18.10.2016, e pas administrimit të të gjitha provave konform nenit 260 të KPP-së, gjykata konstatoi këtë gjendje faktike:

Se është vërtetu se i akuzuari M. L. nga fshati P., ka kryer veprën penale vjedhje e pyllit nga neni 358 paragrafi 1 të KPRK-së, në vendin kohën dhe mënyrën së si është përshkru për së afërm, i në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këtë gjendje faktike gjykata e vërtetoi duke u bazuar në këto prova ;

Dëshmit e dëshmitarëve N. Rr., Sh. M. dhe I. R..

- Pjesërisht edhe nga pranimi indirekt te veprës penale nga mbrojtja e të akuzuarit M. L. .
- Nga fotodokumentacioni nga vendi i ngjarjes dhe fletëparaqitja e rojtarit të pyllit e datës kritike.

Dëshmitari N. Rr., përndryshe rojtari i pyllit për atë zonë ku është kryer vepra penale në dëshmin e vet të dhënë në seancë kryesore të datës 18.10.2016, në mënyre bindësë dhe objective, ashtu siq e ka përshkruar edhe në fletëparaqitje e tij pohoi pasi që ditën kritike ishte ftuar në telefon nga pjestarët e policisë së kosovës e kanë takuar traktorin "...” ngjyrë e ..., të nagrkuar në vendngjarje e të e të fotografuar aty, kam takuar policët Sh. M., I. R. e N. I., që ishim duke e ruajtur, ai pohoi se e njohi traktorin, është i të akuzuarit M. L., i cili me të parë policinë e kishte braktisur traktorin me dru, sihte larguar nga vendi i ngjarjes.

Pohoi se pasi e fotografoi te njejtin , i identifikuar me ato dru ishin prere në pronën e të dëmtuarit N. M. nga K., i cili e kishte lajmruar policine dhe rojtarin e pyllit se atij janë duke ia vjedhur pyllin konkretisht i akuzuari M. .Pohoi se pasi që policia u larguan , urdheroi që të tërhiqet traktori, e që të nesërmen ishte lajmruar i akuzuari në polici, duke dhene alibi gjoja se i ka letrat për drut, por ato nuk i ka të damkosura, por gjë që nuk është e vertet por ato i ka marr në mënyre kunderligjore.

Edhe dëshmitaret policët Sh. M. dhe I. R. pohuan se ditën kritike e kishte marre informatën në telefon nga i dëmtuari, se hajatn poi a vjedhin pyllin duke ia dhënë edhe lokacionin kur ata me te mri aty , jane hasur ne traktorin e braktisur nga i akuzuari, pastaj e kishin ftuar edhe rojtarin e pyllit N. Rr., i cili kishte ardhë pas 30- 40 minutave dhe ai e kishte identifikuar traktorin në fjalë.

Edhe fletëparaqitja dhe fotodokumentacioni me tri fotografi nga vendi i ngjarjes e që gjindet në shkresat e lëndës i mbështesim në tersi dëshmit e rojtarit të pyellit dhe policëve.

Po ashtu edhe i akuzuari në mbrojtjen e vet nuk e mohon rastin se ka ikur nga vendi i ngjarjes duke e braktisur traktorin me dru, por me alibin se drut nuk i ka prere në pyllin prone e te dëmtuarit, por ë pronën e vet dhe nga frika se nuk kanë qenë drutë e damkosura , ku iku nga policia.

Gjykata me kujdes i shqyrtoi dhe i vlerësoi provat e administruara në seancën gjyqesore si dëshmit e tre dëshmitarëve dhe shkresave të tjera të lëndës, të gjitha ato një nga një dhe si tersi , dhe besimin e plotë ua fali dëshmitëve të tre dëshmitarëve N. Rr., Sh. M. dhe I. R. si dhe fotodokumentacionit ku të gjitha ato një nga një dhe si mozaik i bashkuar. vërtetojnë pa medyshje se i akuzuari M. L., është kryes i kësaj veprë penale të përshkruar detalisht në dispozitivin e këtij aktgjykim se ai ditën kritike i kishte prerë 5 copa trungje dru ahu, në pyllin privat të të demtuarit N. M. , i kishte ngarguar në traktorin me rimorkio, për ti bartur për nevojat e tija e që indirekt edhe i akuzuari e pranoi një gjendje të tille por duke e mohuar se drut ishin te pylli të tij e jot ë demtuarit e që besimin ua dha dëshmitareve dhe fotodokumentacionit e indirekt edhe mbrojtës së të akuzuarit ngase veprimet inkriminuesë të të akuzuarit M. L. përmban të gjitha tiparet e kësaj veprë penale dhe se për atë edhe ai është penalisht përgjegjës.

Me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësis së dënimit ndaj të akuzuarit M. L. gjykata pati parasysh rrethanat konform neneit 73 të KPRK-së, ku si rrethanë posaqërisht lehtëuese me faktin se i akuzuari është i moshës shumë të re, baba i një fëmije të mitur, me gjendje të rënd ekonomike dhe jeton në një fshat të largët kufitar gati të boshatisur , se është i pa punë dhe me gjendje të rënd ekonomike, si dhe sjelljen shumë të mirë në gjykatë, ndërsa rrethanë rënduese e vuan dëmin e shkaktuar të të dëmtuarit.

Sipas bindjes së lirë të kësaj gjykate dënimi më gjobë ndaj të akuzuarit është marrë për bazë të gjitha rrethanat e lartcekura , është dënim i drejt me harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësis së te akuzuarit dhe se me këtë dënim do arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 i KPRK-se.

Udhëzimi mbi kerkesen pasurore juridike është i bazuar në nenin 453 e ai mbi hargjimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor në nenin 451 të KPRK-se.

Duke u nisur nga të cekurat më lart është vendosur sinë dispozitivin e këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NE GJILAN**

**Departamenti i përgjithshëm**

**P.nr.146/2016 e dt.18.10.2016**

**Sek. Juridike**

*Naile Neziri*

**Gjyqtari i vetem gjykues,**

*Ramiz Azizi*

**KWSHILLA JURIDIKE** - Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimi të të njejtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.